- zvogëlimi i pabarazive ndërmjet dhe në kuadër të rajoneve të planit, dhe ngritja e kualitetit të jetës për të gjithë qytetarët;

- rritja e konkurrencës së rajoneve të planit nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre të inovacionit, shfrytëzimi optimal dhe valorizimi i pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe veçorive ekonomike të rajoneve të ndryshme;

- ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të veçantë të rajoneve të planit, si dhe afirmimi dhe zhvillimi i tyre;

- rivitalizimi i fshatrave dhe zhvillimi i rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, dhe

- përkrahja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe tejkufitar të njësive të vetadministrimit lokal, në funksion të nxitjes së zhvillimit të barabartë rajonal.

Parimet

Neni 4

Parimet e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, janë:

- programimi – ndërtimi i sistemit shumëvjeçar të programimit dhe zbatimit të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, që përfshin identifikimin e prioriteteve dhe masave të politikës, financimin, udhëheqjen dhe kontrollin e tyre;

- partneriteti – bashkëpunimi gjatë përgatitjes, implementimit, monitorimit dhe evalvacionit të dokumenteve të planit për zhvillim rajonal, ndërmjet organeve të pushtetit qendror dhe njësive të vetadministrimit lokal, partnerëve ekonomikë dhe socialë dhe përfaqësuesve të tjerë relevantë të shoqërisë qytetare;

- harmonizimi – qëllimet, prioritetet dhe masat në dokumentet e planit për zhvillimin rajonal, harmonizohen me qëllimet, prioritetet dhe masat në dokumentet strategjike zhvillimore në nivel nacional, dhe në dokumentet programore për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian;

- bashkëfinancimi – bashkëfinancimi i masave të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e njësive të vetadministrimit lokal, fondet e Unionit Evropian dhe burimet e tjera ndërkombëtare, si dhe mjetet e personave juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj;

- transparenca – informimi i rregullt, me kohë dhe objektiv i opinionit, për masat e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, si dhe mundësimi i qasjes së lirë të informatat për palët e interesuara;

- subsidiariteti – përgatitjen, realizimin, kontrollin dhe vlerësimin e programeve dhe masave për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, i kryejnë rajonet e planit dhe njësitë e vetadministrimit lokal, përveç nëse nuk janë të përshtatshme nga kompetenca e tyre, ose nuk janë në kompetencë të organeve shtetërore.

- qëndrueshmëria – respektimi i komponentëve ekonomikë, socialë dhe ekologjikë të zhvillimit, gjatë krijimit të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

III. PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL

Rajonet e planit

Neni 5

(1) Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimit të masave dhe instrumenteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, caktohen rajonet e planit.

(2) Rajonet e planit nga paragrafi 1 i këtij neni, janë njësitë e NNJTS nivelit 3, të përcaktuara me aktin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për përcaktimin e nomenklaturës së njësive territoriale të statistikës - NNJTS

Rajonet me nevoja specifike zhvillimore

Neni 6

(1) Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimit të masave dhe instrumenteve specifike për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, caktohen rajonet me nevoja specifike zhvillimore.

(2) Rajonet me nevoja specifike zhvillimore sipas paragrafit 1 të këtij neni, janë:

- rajonet kufitare, rurale, kodrinore – malore dhe të tjera, që ngecin në zhvillim;

- rajonet me pasuri natyrore dhe trashëgimi kulturor, të cilat janë të mbrojtura me ligj, dhe

- rajonet e tjera me nevoja specifike zhvillimore, të përcaktuara me ligj.

(3) Rajoni me nevoja specifike zhvillimore mund të shtrihet në rajonin e një apo më tepër njësive të vetadministrimit lokal, në kuadër të një apo më tepër rajoneve të planit.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miraton listën e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore me propozimin e Këshillit për zhvillim të harmonizuar regional të Republikës së Maqedonisë.

(5) Lista e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, rivedohet në çdo të pestin vit.

Neni 7

(1) Kriteret themelore për caktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore përcaktohen janë shkalla e zhvillimit ekonomik, indeksi demografik, pozita gjeografike, shkalla e ndërtimit të infrastrukturës teknike dhe sociale, dhe vlera e pasurisë natyrore dhe trashëgimia kulturore.

(2) Kriteret dhe Indikatorët më të afërt për caktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Dokumentet e planit

Neni 8

Planifikimi i zhvillimit rajonal kryhet me dokumentet e planit.

(1) Dokumentet e planit harmonizohen me Planin hapësinor të Republikës së Maqedonisë, dokumentet strategjike zhvillimore në nivel nacional dhe dokumentet programore për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 9

(1) Dokumentet e planit për zhvillimin rajonal janë:
- strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë;

- programi për zhvillimin e rajonit të planit.

(2) Për zbatimin e dokumenteve të planit nga paragrafi 1 i këtij neni, miratohen plane aksionare.

(3) Dokumentet e planit nga paragrafi 1 i këtij neni përgatiten në bazë të Metodologjisë për përpilimin e dokumenteve të planit.

(4) Metodologjinë nga paragrafi 3 i këtij neni e përcakton ministri i Vetadministrimit Lokal.

(5) Në përgatitjen e dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal detyrimisht konsultohen palët e prekura në nivel nacional dhe lokal.

Strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë

Neni 10

(1) Strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia) miratohet për periudhën prej dhjetë vjetësh.

(2) Strategjinë e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Strategjia për periudhën e ardhshme të planit miratohet më së voni 12 muaj para skadimit të periudhës rrjedhëse të planit.

(4) Për zbatimin e Strategjisë miratohet plani trevjeçar aksionar.

(5) Planin aksionar nga paragrafi 4 i këtij neni, e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(6) Plani aksionar nga paragrafi 4 i këtij neni për periudhën e ardhshme të planit, miratohet më së voni gjashtë muaj para skadimit të periudhës rrjedhëse të planit.

Neni 11

(1) Në Strategji përcaktohen:
- koncepti, prioritetet dhe qëllimet strategjike të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal;

- masat dhe instrumentet për nxitjen e zhvillimit të rajoneve të planit, dhe vendeve me nevoja specifike zhvillimore, dhe

- financimi, institucionet dhe mekanizmat për implementimin e masave të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

(2) Strategjia paraqet bazë për përpilimin e programeve për zhvillimin e rajoneve të planit.

Programi për zhvillimin e rajonit të planit

Neni 12

(1) Programi për zhvillimin e rajonit të planit miratohet për periudhën prej pesë vjetësh.

(2) Programi për zhvillimin e rajonit të planit përpilohet veç e veç për secilin rajon të planit, në pajtim me Strategjinë dhe dokumentet programore, për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

(3) Programin për zhvillimin e rajonit të planit e përpilon Qendra për zhvillimin e rajonit të planit, në pajtim me Metodologjinë për përpilimin e dokumenteve të planit.

(4) Programin për zhvillimin e rajonit të planit e miraton Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit, pas pajtimit paraprak nga Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë.

(5) Programi për zhvillimin e rajonit të planit për periudhën e ardhshme të planit, miratohet më së voni gjashtë muaj para skadimit të periudhës rrjedhëse të planit.

Neni 13

(1) Për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit miratohen plane vjetore aksionare.

(2) Planet vjetore aksionare për vitin e ardhshëm miratohen deri në fund të tremujorit të tretë, në vitin rrjedhës.

Neni 14

(1) Në Programin për zhvillimin e rajonit të planit, përcaktohen:

- qëllimet për zhvillimin e rajonit të planit;

- masat dhe instrumentet për nxitjen e zhvillimit të rajonit të planit;

- masat dhe instrumentet për nxitjen e zhvillimit të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, nëse janë të përcaktuara në rajon, dhe

- burimet financiare, dinamika kohore dhe indikatorët për zbatimin e masave për nxitjen e zhvillimit.

(2) Në Program përcaktohen prioritetet për zhvillimin e rajonit dhe prioritetet për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, nëse të atilla janë përcaktuar në rajon.

(3) Programi për zhvillimin e rajonit të planit është bazë për përgatitjen e planeve të njëjësive të vetadministrimit lokal në sferën e zhvillimit të tyre ekonomik, social, urbanistik, ekologjik, kulturor dhe zhvillimit tjetër.

IV. BARTËSIT E POLITIKËS PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARABARTË RAJONAL

Neni 15

(1) Bartësit e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, janë:

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

- Këshilli për zhvillimin rajonal të barabartë të Republikës së Maqedonisë;

- Ministria e Vetadministrimit Lokal; dhe

- Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit.

(2) Në planifikimin e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal marrin pjesë edhe Byroja për zhvillimin rajonal edhe Qendrat për zhvillimin e rajoneve të planit.

Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal i Republikës së Maqedonisë

Neni 16

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e formon Këshillin për zhvillimin e barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal).

(2) Anëtarë të Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal, janë:

- zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i obliguar për çështjet ekonomike,

- ministrat që udhëheqin me Ministrinë e Vetadministrimit Lokal; Financave; Ekonomisë; Transportit dhe Ndërlidhjeve; Punës dhe Politikës Sociale; Kulturës; Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, dhe

- kryetarët e këshillave për zhvillimtë rajoneve të planit, dhe
 - kryetarët e Bashkësisë së Njësive të Vetadministrimit lokal.

(3) Në punën e Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal, mund të marrin pjesë edhe personat shkencorë dhe profesionalë, nga sfera e zhvillimit rajonal.

(4) Me Këshillin për zhvillimin e barabartë rajonal udhëheq zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i obliguar për çështjet ekonomike.

(5) Mënyra e punës së Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal rregullohet me rregullore pune.

(6) Përkrahjen profesionale dhe administrative teknike, për punën e Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal, e siguron Ministria e Vetadministrimit Lokal.

Neni 17

Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal:

- harmonizon politikën për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, me politikën e sektorëve dhe politikën makroekonomike të Republikës së Maqedonisë;

- përcakton Propozim-strategjinë për zhvillimin rajonal;
 - jep pajtimin paraprak për programet për zhvillimin e rajoneve të planit;

- përcakton propozimin për kriteret dhe indikatorët më të afërt nga nenet 7 paragrafi (2) dhe (30) paragrafi (3) të këtij ligji;

- përcakton propozim-listën për rajonet me nevoja specifike zhvillimore;

- përcakton propozim-vendimin për klasifikimin e njësive të vetadministrimit lokal, dhe rajoneve të planit sipas shkallës së zhvillimit;

- përcakton propozimin për financimin e projekteve konkrete nga mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, të dedikuara për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe të fshatrave;

- jep mendimin për raportet për zbatimin e dokumenteve të planit, për zhvillimin rajonal;

- inicion shqyrtimin e çështjeve nga sfera e zhvillimit rajonal për të cilat është i domosdoshëm koordinimi ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, njësive të vetadministrimit lokal dhe palëve të tjera të prekura, dhe

- shqyrton çështje të tjera nga sfera e zhvillimit të barabartë rajonal.

Ministria e Vetadministrimit Lokal

Neni 18

(1) Ministria e Vetadministrimit Lokal është kompetente për udhëheqjen e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

(2) Ministria e Vetadministrimit Lokal, në bashkëpunim me ministrinë e tjera që ndërmarrin masa për nxitjen e zhvillimit, e definon dhe zbaton politikën për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, në pajtim me qëllimet e politikës ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, dhe me dokumentet programore për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

(3) Ministria e Vetadministrimit Lokal i kryen punët si vijojnë:

- organizon dhe koordinon përgatitjen e dokumenteve nacionale strategjike të planit për zhvillimin rajonal;

- siguron harmonizimin e Strategjisë me dokumentet programore për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian;

- përgatit dhe ia dërgon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë raportet për zbatimin e dokumenteve të planit, për zhvillimin rajonal;

- organizon dhe koordinon aktivitetet për përcjelljen dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal;

- kryen edhe punë të tjera për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, të përcaktuara me ligj.

Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit

Neni 19

(1) Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit formohet për secilin rajon të planit.

(2) Mbledhjen konstitutive të Këshillit për rajonin e planit e thirr kryetari i komunës i njësive të vetadministrimit lokal, me numër më të madh banorësh në rajonin e planit.

(3) Anëtarë të Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit janë kryetarët e komunave të njësive të vetadministrimit lokal që hyjnë në përbërjen e rajonit të planit.

(4) Anëtarë të Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit në përbërjen e të cilit është Qyteti i Shkupit janë kryetarët e komunave të njësive të vetadministrimit lokal, që hyjnë në përbërjen e rajonit të planit dhe prefekti i Qytetit të Shkupit.

(5) Kryetari i Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit, me mandat prej dy vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

(6) Në punën e Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit mund të marrin pjesë persona profesionalë për zhvillimin rajonal, përfaqësuesit e odave ekonomike, sindikatave, shoqatave të qytetarëve dhe partnerët e tjerë relevantë nga sektori privat dhe civil.

Neni 20

(1) Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit i kryen punët si vijojnë:

- organizon dhe koordinon aktivitetet për përcjelljen dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal;

- miraton Programin për zhvillimin e rajonit të planit, pas pajtimit paraprak nga Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal;

- miraton planin vjetor aksionar për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit;

- përcakton listën vjetore për propozim-projektet për zhvillimin e rajonit të planit;

- i dërgon propozime Byrosë e zhvillimit rajonal për identifikimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, në kuadër të rajonit të planit, në pajtim me kriteret nga neni 7 të këtij ligji;

- siguron koordinimin e aktiviteteve të njësive të vetadministrimit lokal, shoqatave të qytetarëve, agjencive dhe institucioneve shtetërore në kuadër të rajonit, të cilat veprojnë në sferën e zhvillimit rajonal;

- inicion shqyrtimin e çështjeve të lidhura me zhvillimin rajonal për të cilat është i domosdoshëm koordinimi ndërmjet njësive të vetadministrimit lokal, dhe partnerëve nga sektori privat dhe civil;

- promovon bashkëpunimin tejkufitar me rajonet e vendeve të tjera, në bazë të interesave të përbashkëta, dhe

- kryen punë të tjera nga sfera e zhvillimit rajonal, të përcaktuara ligj.

(2) Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit e miraton planin vjetor për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit.

Neni 21

Mënyra e punës së Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit rregullohet me rregullore pune.

(1) Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit vendos me 2/3 e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

(2) Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit, sipas rregullës mban mbledhje në selinë e njësive më të madhe të vetadministrimit lokal sipas numrit të banorëve, në rajonin e planit.

(3) Punët profesionale dhe administrative teknike të Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit i kryen Qendra për zhvillimin e rajonit të planit.

Byroja për zhvillim rajonal

Neni 22

Byroja për zhvillim rajonal (në tekstin e mëtejshëm: Byroja) është organ në përbërje të Ministrisë së Vetëadministrimit lokal, me cilësi të personit juridik.

(1) Drejtorin e Byrosë e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 23

Byroja i kryen punët si vijojnë:

- përgatit bazën analitike dokumentuese për përpilimin e dokumenteve strategjike dhe operative të planit për zhvillimin rajonal;

- përpilon propozim-metodologjinë për përpilimin e dokumenteve të planit;

- përgatit raporte vjetore për implementimin e Planit aksionar të Strategjisë;

- përpilon propozim-vendimin për kriteret dhe indikatorët për identifikimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore;

- përpilon propozim-listën për rajonet me nevoja specifike zhvillimore;

- përpilon propozim-kriteret për shkallën e zhvillimit të njësisve të vetëadministrimit lokal dhe të rajoneve;

- përpilon propozim-aktin për klasifikimin e njësisve të vetëadministrimit lokal dhe rajoneve të planit sipas shkallës së zhvillimit;

- u ofron ndihmë profesionale Qendrave për zhvillimin e rajoneve të planit gjatë përgatitjes së programeve për zhvillimin e rajoneve të planit dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera të lidhura me zhvillimin rajonal;

- informon palët e prekura për llojet dhe vëllimin e mjeteve dhe për instrumentet për nxitjen e zhvillimit rajonal;

- zbaton dhe kujdeset për mirëmbajtjen e sistemit të informacionit për zhvillimin rajonal në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Statistikës, dhe

- kryen edhe punë të tjera nga sfera e zhvillimit rajonal, të përcaktuara ligj.

Qendra për zhvillimin e rajonit të planit

Neni 24

(1) Për kryerjen e punëve profesionale me rëndësi për zhvillimin e rajonit të planit themelohet Qendra për zhvillimin e rajonit të planit.

(2) Qendra për zhvillimin e rajonit të planit themelohet për secilin rajon të planit.

(3) Qendrën për zhvillimin e rajonit të planit e themelojnë njësitë e vetëadministrimit lokal, që hyjnë në përbërjen e rajonit të planit.

(4) Me aktin për themelimin e Qendrës për zhvillimin e rajonit të planit rregullohet organizimi, puna dhe financimi i saj.

(5) Qendra për zhvillimin e rajonit të planit e ka cilësinë e personit juridik.

(6) Selia e Qendrës për zhvillimin e rajonit të planit është në njësinë e vetëadministrimit lokal, me numër më të madh banorësh në rajonin e planit.

Neni 25

(1) Qendra për zhvillimin e rajonit të planit ka udhëheqës, i cili zgjidhet me konkurs publik.

(2) Udhëheqësin e Qendrës e zgjedh Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit për periudhën prej katër vjetësh.

(3) Puna rrjedhëse e Qendrës për zhvillimin e rajonit të planit financohet nga buxhetet e njësisve të vetëadministrimit lokal, që hyjnë në përbërjen e rajonit të planit.

Neni 26

(1) Qendra për zhvillimin e rajonit të planit i kryen punët si vijojnë:

- përgatit propozim-programin për zhvillimin e rajonit të planit;

- përgatit propozim-planin aksionar për implementimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit;

- përgatit propozim-projektet për zhvillimin të rajonit të planit, edhe për rajonet me nevoja specifike zhvillimore;

- koordinon aktivitetet e lidhura me implementimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit, dhe i realizon projektet për zhvillimin e rajonit të planit;

- përgatit plan vjetor për zbatimin e Programit për zhvillimin e rajonit të planit;

- u siguron informata palëve të interesuara për rrjedhën e realizimit të Programit për zhvillimin e rajonit të planit dhe të çështjeve të tjera të lidhura me zhvillimin rajonal;

- u siguron ndihmë profesionale dhe teknike njësisve të vetëadministrimit lokal gjatë përgatitjes së programeve të tyre për zhvillim;

- u siguron shërbime profesionale shoqatave të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara për përgatitjen e projekteve nga sfera e zhvillimit rajonal;

- nxit bashkëpunimin ndërkomunal në kuadër të zhvillimit sipas planit;

- zbaton projekte për nxitjen e zhvillimit të rajonit të planit të financuara nga fondet e Unionit Evropian dhe burime të tjera ndërkombëtare;

- kryen promovimin e mundësive zhvillimore të rajonit të planit, dhe

- kryen punë profesionale dhe administrative teknike për nevojat e Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit.

(2) Qendra për zhvillimin e rajonit të planit i paraqet raportin vjetor për punën e vet Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit dhe këshillave të njësisve të vetëadministrimit lokal.

V. FINANCIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL

Burimet e financimit të zhvillimit rajonal

Neni 27

(1) Burimet e financimit të zhvillimit rajonal, janë:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë;

- buxhetet e njësisve të vetëadministrimit lokal;

- fondet e Unionit Evropian;

- burime të tjera ndërkombëtare;

- donacionet dhe sponsorimet nga personat fizikë dhe juridikë;

- mjete të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për çdo vit ndahen mjete në lartësi prej së paku 1% nga PBSH.

(1) Për nxitjen e zhvillimit të rajonit të planit, njësitë e vetëadministrimit lokal mund të shfrytëzojnë edhe mjete nga fondet e Unionit Evropian.

(2) Shfrytëzimi i mjeteve nga fondet e Unionit Evropian rregullohet me aktin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Instrumentet për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

Neni 28

(1) Instrumentet për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë, janë:

- depozitimet kapitale;

- grantet e pakthyeshme;

- financimi dhe bashkëfinancimi i përgatitjes së analizave, studimeve, dokumenteve të planit dhe planeve aksionare, dhe

- financimi i ndërtimit të kapaciteteve institucionale për zhvillimin rajonal në Republikën e Maqedonisë.

(2) Për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal mund të ndahet edhe ndihma shtetërore në formë të huave me kushte të volitshme; garancive për hua; sigurimit të kredive; lehtësimeve tatimore, subvencioneve dhe instrumenteve të tjera, në pajtim me ligjin.

V. SHPËRNDARJA DHE NDARJA E MJETEVE
PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË BARABARTË
RAJONAL

**Shpërndarja e mjeteve
për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal**

Neni 29

(1) Mjetet nga neni 27 paragrafi 2 i këtij ligji për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, i shpërndan Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, shpërndahen:

- 70% për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit;
- 20% për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore;
- 10% për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave.

Neni 30

(1) Mjetet nga neni 29 paragrafi 2 alineja 1 e këtij ligji për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, shpërndahen nëpër rajonet e planit, në bazë të klasifikimit të rajoneve të planit sipas shkallës së zhvillimit.

(2) Baza për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve të planit janë indeksi i zhvillimit ekonomik dhe indeksi demografik.

(3) Kriteret dhe indikatorët më të afërt për caktimin e shkallës së zhvillimit të rajoneve të planit përcaktohen me aktin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(4) Klasifikimi i rajoneve të planit sipas shkallës së zhvillimit përcaktohet me aktin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 31

Mjetet nga neni 29 paragrafi 2 alineja 2 e këtij ligji për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, u ndahen njësisë të vetadministrimit lokal në të cilat janë caktuar rajonet me nevoja specifike zhvillimore.

Neni 32

Mjetet nga neni 29 paragrafi (2) alineja 3 të këtij ligji për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave ndahen nëpër rajone, me ç'rast secili rajon i planit merr pjesë të barabartë.

Neni 33

Mjetet nga neni 29 paragrafi 2 barten në llogarinë e Byrosë për zhvillimin rajonal, e cila e zbaton vendimin për ndarjen e tyre.

**Procedura për grumbullimin dhe për vlerësimin e
propozim-projekteve**

Neni 34

(1) Për shfrytëzimin e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, këshilli për zhvillimin e rajoneve të planit përcakton listën e propozim-projekteve për zhvillimin e rajonit në pajtim me përparësitë në Programin për zhvillimin e rajonit të planit.

Propozim-projektet për të cilat kërkohet financim në vitin vijues i përgatit qendra për zhvillimin e rajonit të planit dhe më së voni deri më 15 dhjetor në vitin në viji ia dërgon Byrosë për zhvillim rajonal.

(2) Rajonet e planit që nuk do të dërgojnë propozim-projekte në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e humbin të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve të ndara për financimin e projekteve, për zhvillimin e rajonit të planit në vitin e ardhshëm.

(3) Rajonet e planit që do të dorëzojnë propozim-projekte, vlera e përgjithshme financiare e të cilave është më e vogël se shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për rajonin e planit për vitin e ardhshëm, e humbin të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve për të cilat nuk kanë dërguar propozim-projekte.

(4) Rajonet e planit për propozim-projektet e dorëzuara, për të cilat do të merret vendim që të mos financohen për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara, e humbin të drejtën e shfrytëzimit të atyre mjeteve.

(5) Mjetet që nuk do të shfrytëzohen në bazë të paragrafit (3), (4) dhe (5) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë i rishpërndan për financimin e projekteve nga rajonet tjera të planit, në pajtim me nenin 30 paragrafi (1).

Neni 35

(1) Për ndarjen e mjeteve nga neni 29 paragrafi 2 alineja 2 e këtij ligji për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, Byroja për zhvillimin rajonal shpall thirrje publike për grumbullimin e propozim-projekteve.

(2) Në thirrje shënohet shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore;

(3) Të drejtën për paraqitjen e propozim-projekteve e kanë njësitë e vetadministrimit lokal në territorin e të cilave janë caktuar rajonet me nevoja specifike zhvillimore.

Neni 36

(1) Për ndarjen e mjeteve nga neni 29 paragrafi 2 alineja 3 e këtij ligji, për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave, Byroja për zhvillimin rajonal shpall thirrje publike për grumbullimin e propozim-projekteve.

(2) Në thirrje shënohet shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave, veç e veç për secilin rajon.

Të drejtën për paraqitjen e propozim-projekteve e kanë njësitë e vetadministrimit lokal, që i takojnë rajonit të planit.

(3) Njësitë e vetadministrimit lokal me seli në qytet, të cilat paraqesin projekte për zhvillimin e fshatrave në përbërjen e tyre, janë të obliguara që të sigurojnë bashkëfinancimin e projektit në shumë prej 50% nga vlera e projektit.

(4) Bashkëfinancimi i projekteve mund të sigurohet nga burimet e veta të hyrjeve, dhe nga burimet e tjera të mjeteve të vendit dhe ndërkombëtare.

(5) Njësitë e vetadministrimit lokal me seli në fshat nuk kanë për obligim bashkëfinancimin e projekteve.

Neni 37

(1) Propozim-projektet për zhvillimin e rajoneve të planit, në rajonet me nevoja specifike zhvillimore dhe në fshatra, të cilat për financim dorëzohen në Byronë për zhvillimin rajonal, detyrimisht duhet t'i përmbajnë elementet si vijojnë:

- emrin e projektit;
- bartësin e projektit;
- qëllimet e projektit;
- rezultatet e pritura nga projekti;
- konstruktin financiar të projektit;
- kohëzgjatjen dhe dinamikën e realizimit të projektit; dhe
- elementet e tjera, varësisht nga specifika e projektit.

(2) Në propozim-projektet për zhvillimin e rajonit të planit dhe të viseve me nevoja specifike të zhvillimit detyrimisht theksohet ndërlidhja e projektit me përparësitë nga Programi për zhvillimin e rajonit të planit.

Neni 38

(1) Propozim-projektet e dërguara për zhvillimin e rajoneve të planit, në rajonet me nevoja specifike zhvillimore dhe në fshatra, i shqyrton dhe vlerëson Komisioni për vlerësimin e propozim-projekteve.

Komisionin e formon Ministria e Vetadministrimit Lokal, dhe përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë.

(2) Kryetari i Komisionit emërohet nga radhët e nëpunësve udhëheqës shtetërorë në Ministrinë e Vetadministrimit Lokal.

(3) Një anëtar i Komisionit emërohet nga radhët e nëpunësve udhëheqës shtetërorë në Ministrinë e Financave.

(4) Dy anëtarë të Komisionit emërohen nga radhët e nëpunësve shtetërorë në Byronë për zhvillimin rajonal.

(5) Tre anëtarë emërohen nga radhët e personave profesionalë nga sfera e zhvillimit rajonal.

Neni 39

(1) Propozim-projektet për zhvillimin e rajoneve të planit dhe propozim-projektet për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore duhet të dalin nga prioritetet e përcaktuara në Programin për zhvillimin e rajonit të planit.

(2) Propozim-projektet nga paragrafi 1 i këtij neni, që nuk e plotësojnë këtë kusht nuk do të shqyrtohen.

(3) Procedura dhe metodologjia për vlerësimin e propozim-projekteve përcaktohen me rregulloren që e miraton Ministria e Vetadministrimit Lokal.

Ndarja e mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

Neni 40

(1) Pas vlerësimit të kryer të projekteve, Komisioni përgatit propozim-lista për financimin e:

- projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit;
- projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe
- projekteve për zhvillimin e fshatrave.

(2) Propozim-listat nga alineja 1 dhe 3 nga paragrafi 1 i këtij neni, përgatiten veç e veç për secilin rajon.

(3) Propozim-listat i dërgohen Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal.

Neni 41

(1) Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal, në bazë të propozim-listave e përcakton propozimin për financimin e projekteve konkrete për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe fshatrave.

(2) Gjatë përcaktimit të propozimit për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit dhe zhvillimin e fshatrave, Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal mban llogari për përfaqësimin e drejtë gjatë ndarjes së mjeteve të gjitha komunave, që bëjnë pjesë në rajonin e planit.

Neni 42

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të propozimit nga neni 41 paragrafi 1 të këtij ligji, merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe fshatrave.

Neni 43

(1) Në bazë të Vendimit për ndarjen e mjeteve, Byroja për zhvillimin rajonal lidh marrëveshje për realizimin e projekteve.

(2) Marrëveshjet për realizimin e projekteve për zhvillimin e rajonit të planit lidhen me qendrat për zhvillimin e rajoneve të planit, të cilat i realizojnë projektet në bashkëpunim me komunat me të cilat ka të bëjnë.

(3) Marrëveshjet për implementimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe zhvillimin e fshatrave, lidhen me komunat që janë bartëse të projekteve.

(4) Mënyra dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare përcaktohen me marrëveshje.

VII. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Përcjellja e zbatimit të dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal

Neni 44

(1) Përcjelljen e realizimit të Strategjisë për zhvillimin rajonal e kryen Qeveria e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet raportit vjetor për zbatimin e planit aksionar të Strategjisë.

(2) Raportin nga paragrafi 1 i këtij neni e përgatit Ministria e Vetadministrimit Lokal dhe ia dërgon Qeverisë, pas mendimit paraprak nga Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal.

Neni 45

(1) Përcjelljen e zbatimit të Programit për zhvillimin e rajonit të planit e kryejnë Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal, këshilli për zhvillim i rajonit të planit dhe këshillat e komunave që bëjnë pjesë në rajonin e planit, nëpërmjet raportit vjetor për realizimin e Programit.

(2) Raportin nga paragrafi 1 i këtij neni e përgatit qendra për zhvillimin e rajonit të planit dhe ia dërgon këshillit për zhvillim të rajonit të planit.

(3) Raportin nga paragrafi (1) të këtij neni këshilli për zhvillimin e rajonit të planit e ia dërgon Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal dhe këshillave të komunave që bëjnë pjesë në rajonin e planit.

Përcjellja e shfrytëzimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

Neni 46

(1) Përcjelljen e shfrytëzimit të mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal e kryen Byroja për zhvillimin rajonal nëpërmjet raporteve për realizimin e projekteve për të cilat janë ndarë mjetet financiare.

(2) Për projektet për zhvillimin e rajoneve të planit, raportet për realizim i përgatit Qendra për zhvillimin e rajonit të planit dhe ia dërgon Byrosë për zhvillimin rajonal, në pajtim me dinamikën kohore të përcaktuar në marrëveshjen për realizimin e projektit.

(3) Për projektet për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe për zhvillimin e fshatrave, raportet për realizim i përgatiten bartësit e projekteve dhe ia dërgojnë Byrosë për zhvillimin rajonal, në pajtim me dinamikën kohore, të përcaktuar në marrëveshjen për realizimin e projektit.

Vlerësimi i dokumenteve të planit për zhvillimin rajonal

Neni 47

Strategjia për zhvillimin rajonal dhe Programi për zhvillimin e rajonit të planit vlerësohen nëpërmjet vlerësimit preliminar, rrjedhës dhe përfundimtar.

Neni 48

(1) Vlerësimi preliminar i Strategjisë për zhvillimin rajonal dhe Programeve për zhvillimin e rajonit të planit, kryhet para fillimit të zbatimit të dokumenteve të planit.

(2) Me vlerësimin preliminar bëhet vlerësimi i koherencës dhe harmonizimit të qëllimeve, prioritetëve dhe masave ndërmjet Strategjisë për zhvillimin rajonal dhe Programeve për zhvillimin e rajoneve të planit, si dhe harmonizimi i tyre me qëllimet, masat dhe prioritetet në dokumentet strategjike zhvillimore në nivel nacional, dhe dokumentet programore për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 49

(1) Vlerësimi rrjedhës i Strategjisë për zhvillimin rajonal dhe Programeve për zhvillimin e rajoneve të planit, kryhet në mesin e periudhës së zbatimit të dokumenteve të planit.

(2) Me vlerësimin rrjedhës bëhet vlerësimi i realizimit dhe efekteve nga masat e zbatuara, për nxitjen e zhvillimit rajonal, të identifikuar në Strategjinë dhe Programet për zhvillimin e rajoneve të planit.

Neni 50

(1) Vlerësimi përfundimtar kryhet pas përfundimit të periudhës së zbatimit të dokumenteve të planit.

(2) Me vlerësimin përfundimtar bëhet vlerësimi i shkallës së realizimit të dokumentit të planit, plotësimit të prioriteteve dhe qëllimeve nga dokumentet e planit, dhe për efektet e arritura për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

Neni 51

(1) Për vlerësimin e zbatuar preliminar, rrjedhës dhe përfundimtar, përgatiten raporte të cilat janë bazë për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të planit.

(2) Procedura për zgjedhjen e vlerësuesve dhe metodologjia për vlerësimin, rregullohen me Rregulloren që e miraton ministri i Vetadministrimit Lokal.

Vlerësimi i realizimit të projekteve

Neni 52

Vlerësimi për realizimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe fshatrave, që financohen nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, kryhet përmes vlerësimit preliminar, rrjedhës dhe përfundimtar.

Neni 53

(1) Vlerësimi preliminar kryhet në propozim-projektet e paraqitura për financim nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

(2) Me vlerësimin preliminar të propozim-projekteve bëhet vlerësimi i përbushjes së kushteve të përcaktuara për financim nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

(3) Vlerësimin preliminar të propozim-projekteve e kryen Komisioni për vlerësimin e projekteve, në pajtim me nenin 39 të këtij ligji.

Neni 54

(1) Vlerësimi rrjedhës i projekteve kryhet gjatë realizimit të projekteve.

(2) Me vlerësimin rrjedhës të projekteve bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së shfrytëzimit të mjeteve, respektimit të dinamikës kohore për realizimin e aktiviteteve të parapara dhe efekteve nga realizimi i tyre.

Neni 55

(1) Vlerësimi përfundimtar i projekteve kryhet pas përfundimit të projekteve.

(2) Me vlerësimin përfundimtar bëhet vlerësimi i suksesit të përgjithshëm për realizimin e projektit, përshtatshmëria e shfrytëzimit të mjeteve, plotësimit të qëllimeve të parashtruara dhe realizimit të rezultateve të pritura.

Neni 56

(1) Për vlerësimin e zbatuar preliminar, rrjedhës dhe përfundimtar, përgatiten raporte të cilat janë bazë për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të planit.

(2) Zgjedhja e vlerësuesve, procedura dhe metodologjia për vlerësimin rrjedhës dhe përfundimtar të projekteve, rregullohen me rregulloren që e miraton ministri i Vetadministrimit Lokal.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 57

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të dispozitave të këtij ligji e kryen Ministria e Vetadministrimit Lokal.

Neni 58

Kontrollin financiar të punës materiale financiare të Byrosë dhe Qendrave për zhvillimin e rajoneve të planit, e kryen Ministria e Financave dhe Enti shtetëror i revizionit.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 59

Këshillat për zhvillimin e rajoneve të planit do të konstituohen në afat prej 45 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 60

Këshilli për zhvillimin të barabartë rajonal do të konstituohet në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 61

Qendrat për zhvillimin e rajoneve të planit do të themelohen në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 62

(1) Puna rrjedhëse e Qendrës për zhvillimin e rajonit të planit, në pesë vjetët e para financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal, që hyjnë në përbërjen e rajonit të planit, në përpjesëtim 50:50.

(2) Kryetarët e komunave - anëtarë të Këshillit për zhvillimin e rajonit të planit dhe ministri i Vetadministrimit Lokal, lidhin marrëveshje për bashkëfinancimin e Qendrës për zhvillimin e rajonit të planit.

(3) Për realizimin e marrëveshjes nga paragrafi 2 i këtij neni dhe transferimin e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, kryetarët e komunave - anëtarë të Këshillit të rajonit të planit, janë të obliguar që paraprakisht të sigurojnë 50% nga mjetet e nevojshme për funksionimin e Qendrës nga Buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal në përbërjen e rajonit të planit.

Neni 63

Dokumentet e planit për zhvillimin rajonal të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 64

Metodologjinë nga neni 9 paragrafi 3 i këtij ligji do ta miratojë ministri i Vetadministrimit Lokal në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 65

Aktet nga neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2 dhe nga neni 30 paragrafët 3 dhe 4 të këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i miratojë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 66

Rregulloret nga neni 39 paragrafi 3, neni 51 paragrafi 2 dhe nga neni 56 paragrafët 2 të këtij ligji, ministri i Vetadministrimit Lokal do t'i miratojë në afat prej 9 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 67

Sistemi i informacionit për zhvillimin rajonal nga neni 23 paragrafi 1 alineja 10 e këtij ligji do të vendoset në afat prej dymbëdhjetë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 68

(1) Ndarja e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin rajonit të planit në vitin 2008 do të bëhet në bazë të propozim-projekteve të paraqitura nga ana e komunave në rajonin e planit.

(2) Propozim-projektet nga paragrafi (1) të këtij neni komunat i paraqesin pas mendimit paraprak të këshillit për zhvillimin e rajonit të planit për rëndësinë e projekteve për zhvillimin e rajonit.

(3) Vendimi për financimin e projekteve në vitin 2008 merret në bazë të përparësive të përcaktuara në Strategjinë për zhvillimin e rajonit.

(4) Marrëveshjet për realizimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit në vitin 2008 lidhen me komunat të cilat i kanë paraqitur propozimet.

Neni 69

Nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, Byroja për rajonet e zhvilluara ekonomikisht në mënyrë të pamjaftueshme, vazhdon të punojë si Byro për zhvillimin rajonal.

Neni 70

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për nxitjen e zhvillimit të rajoneve të zhvilluara ekonomikisht në mënyrë të pamjaftueshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 2/94 dhe 39/99).

Neni 71

(1) Personat që e kanë fituar të drejtën e pagesës së kontributeve për sigurim pensional invalidor dhe shëndetësor, në pajtim me Ligjin për nxitjen e zhvillimit të rajoneve të zhvilluara ekonomikisht në mënyrë të pamjaftueshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 2/94 dhe 39/99), deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë ta shfrytëzojnë deri në realizimin e të drejtës për pension në pajtim me ligjin.

(2) Mjetet për realizimin e të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni, sigurohen nga mjetet nga neni 29 paragrafi 2 alineja 1 të këtij ligji.

Neni 72

Pagesa e mjeteve për regreset e lejuara të një pjese nga kamatat për kreditë e shfrytëzuara, në pajtim me Ligjin për nxitjen e zhvillimit të rajoneve të zhvilluara ekonomikisht në mënyrë të pamjaftueshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 2/94 dhe 39/99), deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, vazhdon deri në përfundimin e pagesës së kredive.

Neni 73

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 1 janar 2008, përveç dispozitave të Kreut III dhe Kreut IV të këtij ligji.

831.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

УКАЗ

**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА
ЗАШТИТА НА ПОТРОШУВАЧИТЕ ПРИ
ДОГОВОРИ ЗА ПОТРОШУВАЧКИ КРЕДИТИ**

Се прогласува Законот за заштита на потрошувачите при договори за потрошувачки кредити,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 16 мај 2007 година.

Бр. 07-2219/1
16 мај 2007 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Бранко Црвенковски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Љубиша Георгиевски, с.р.

**ЗАКОН
ЗА ЗАШТИТА НА ПОТРОШУВАЧИТЕ ПРИ ДО-
ГОВОРИ ЗА ПОТРОШУВАЧКИ КРЕДИТИ**

I. ОПШТИ ОДРЕДБИ

Член 1

(1) Со овој закон се уредува заштитата на потрошувачите при склучување и реализација на договори за потрошувачки кредит во кои како корисник на кредитот се јавува потрошувачот, кој го користи кредитот во обем и за намени предвидени со овој закон.

(2) Со овој закон не се засегаат правата на потрошувачите кои се гарантираат со Законот за заштита на потрошувачите, Законот за облигационите односи и други закони.

(3) За сè што не е уредено со овој закон, на договорот за кредит се применуваат одредбите на Законот за облигационите односи, а на заштита на потрошувачите одредбите од Законот за заштита на потрошувачите.

(4) Доколку поинаку не е уредено со овој закон, на договорите за финансиски лизинг се применуваат одредбите од Законот за лизинг.

Член 2

Одделни изрази употребени во овој закон го имаат следново значење:

1. "Потрошувач" е физичко лице кое склучува договор за потрошувачки кредит согласно со овој закон, а заради остварување на цели кои не се поврзани со вршење на неговата трговска, деловна или професионална дејност;

2. "Давател на потрошувачки кредит" е банка или друго трговско друштво и трговец поединец кое во рамките на својата регистрирана дејност, одобрува кредит или заем на потрошувачот;

3. "Договор за потрошувачки кредит" е:

1) договор со кој давателот на потрошувачки кредит се обврзува на потрошувачот да му одобри или му одобрува определен износ на пари, вклучувајќи договор за одобрени кредитни лимити на кредитни картички, а потрошувачот се обврзува да плаќа одредена камата и добиениот износ да го врати во време и под услови утврдени со договорот,

2) договор за продажба на производи и услуги со одложено плаќање, доколку потрошувачот е обврзан да ја плати цената на повеќе рати со тоа што збирот на износот на сите рати е повисок од цената на производот или услугата и

3) други финансиски договори кои во економска смисла имаат иста намена како договорите за кредит, како што се договорите за финансиски лизинг и договор за закуп на ствари кај кој закупнината се смета за одложено плаќање и на крајот на договорениот период правото на сопственост на стварта преминува на закупувачот;

4. "Кредитен посредник" е физичко или правно лице кое во име на давателот на потрошувачки кредит и за надоместок, врши една или повеќе од следниве активности:

1) дава информации за можностите за склучување на договор за потрошувачки кредит,

2) нуди склучување на договор за потрошувачки кредит или

3) презема други подготвителни активности за склучување на договор за потрошувачки кредит;

5. "Вкупни трошоци на кредитот" се камати, провизии и други надоместоци кои потрошувачот треба да ги плати при одобрувањето и редовната отплата на кредитот и

6. "Годишна стапка на вкупните трошоци" е дисконтна стапка изразена на годишно ниво како однос на вкупните трошоци на кредитот и износот на одобриениот кредит пресметана согласно со членовите 11 и 12 од овој закон и со која износот на одобриениот кредит се изедначува со износите на сите обврски по кредитот што треба да ги плати потрошувачот (отплата на главнина и вкупни трошоци на кредитот).

Член 3

Одредбите од овој закон не се применуваат на:

1) договори за оперативен лизинг и за закуп на ствари, освен договорите за закуп кај кои е предвидено на крајот на договорениот рок правото на сопственост на стварта да премине врз закупувачот;

2) договори за кредит со кои не е предвидено плаќање на камата или други трошоци;

3) договори за кредит кај кои потрошувачот се обврзува да го врати кредитот во период пократок од три месеца;

4) договори за кредит со кои потрошувачот се обврзува да го врати кредитот во најмногу четири рати за период пократок од 12 месеца;

5) договори за дозволено пречекорување на тековна сметка на кои се применуваат само одредбите од членот 8 на овој закон;

6) договори за кредит на износи помали од 200 и повисоки од 20.000 евра во денарска противвредност и

7) договори за кредит кои се резултат на судско порамнување или порамнување пред орган на државна управа, како и одложено плаќање по извршна исправа со посредство на извршител.

Член 4

Доколку давателот на потрошувачки кредит склучи повеќе договори за потрошувачки кредит за износи помали од 200 евра во денарска противвредност, а за иста економска цел, тие договори за потребите на овој закон се сметаат за еден договор за потрошувачки кредит.

II. РЕКЛАМИРАЊЕ И ПОНУДА

Член 5

